

Si te aplikoni per statusin "Settled" nese keni statusin "Pre Settled"

Në këtë udhëzues do të gjeni:

- Si të aplikoni për statusin "Settled"
- Si t'i kuptoni rregullat
- Grumbullimin e dokumenteve
- Përgjigje për pyetjet më të shpeshta

Një person që di të përdorë kompjuterin ose një smartphone, për shembull një anëtar i familjes ose një mik, mund t'ju ndihmojë për të lexuar këtë udhëzues.

Nëse keni statusin "Pre-Settled" dhe synoni të vazhdoni të jetoni dhe të punoni në MB në mënyrë të pacaktuar, duhet të aplikoni për "Settled Status", i cili mbron të drejtat tuaja për:

- Të jetoni, punoni dhe studioni në MB
- Të përdorni shërbimin NHS (Shërbimi Kombëtar i Shëndetit) falas
- Të aplikoni për fonde publike si ndihma dhe pensione
- Të udhëtoni lirshëm
- Të qëndroni jashtë MB për 5 vite rresht pa humbur statusin tuaj

Disclaimer: Ky udhëzues përfshin vetëm kërkesat për rezidencë. Konsultohuni me një avokat nëse keni një çështje komplekse.

Lexoni faqen e fundit të kësaj fletëpalosjeje nëse keni nevojë për më shumë suport.

Kur dhe si të aplikoni

Mund të aplikoni për statusin "Settled" pasi të keni jetuar në MB vazhdimisht për 5 vjet, duke filluar nga data kur keni filluar të jetoni rregullisht këtu, jo nga data kur ju është dhënë statusi "Pre-Settled".

Ju këshillojmë të aplikoni për statusin "Settled" sa më shpejt që të jetë e mundur.

Duhet të bëni një aplikim të ri, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

1. Shkarkoni aplikacionin EU Exit: ID Document Check në smartphone tuaj dhe ndiqni hapat që tregohen. Do t'ju kërkohet të bëni një foto tuajën, të skanoni dhe të gjeni çipin mbi dokumentin tuaj biometrik (p.sh. pasaporta).

2. Pasi të keni përfunduar me kontrollin e identitetit, plotësoni aplikimin tuaj online and përdorni adresën e internetit për akses në cdo kohë:

<https://apply-to-visit-or-stay-in-the-uk.homeoffice.gov.uk/euss>

3. Vendosni Numrin tuaj Unik të Aplikimit (UAN) për statusin e para-vendosur. Është një numër me 16 shifra që fillon me 3434-. Mund ta gjeni në letrën "Status Outcome" që konfirmon statusin tuaj të para-vendosur.

4. Vendosni numrin tuaj të sigurimit (National Insurance Number / NIN), nëse e keni, për të lejuar Home Office të bëjë një kontroll automatik me HMRC dhe DWP.

5. Ngarkoni dëshmi të 5 viteve të qëndrimit tuaj të vazhdueshëm në MB, nëse ju kërkohet.



Kërkesat për leje qëndrimi

Për t'u kualifikuar për statusin "Settled", ju duhet të dëshmoni se keni jetuar në MB për 5 vite rresht. Ka dy mënyra me të cilat Home Office e kontrollon këtë:

Opsioni 1: Qëndrim i vazhdueshëm (rregulli 6/12)

Ju duhet të:

- Keni filluar jetesën tuaj në MB para 31 Dhjetor 2020.
- Keni jetuar në MB për të paktën 5 vite të vazhdueshme
- Për çdo periudhë 12 mujore, ju nuk jeni larguar nga MB për më shumë se 6 muaj në total, me përjashtim të rasteve të vecanta.

Përjashtimet janë të lejueshme në situata specifike, si për shembull një mungesë e vetme prej më shumë se 6 muajsh por më pak se 12 muaj lejohet për arsye të rëndësishme (Covid-19, sëmundje të rënda, shtatzani ose lindje, studime ose trajnime ose një vend pune jashtë shtetit).

Duhet të siguronit prova që justifikojnë mungesat tuaja, si letra nga spitali, shkolla, punëdhënësi, teste pozitive për Covid-19, etj.

Edhe nëse keni qenë jashtë MB për më shumë se 6 muaj në një vit të caktuar, ju mund të kualifikoheni për statusin Settled nëse mund të tregoni se periudha totale e jetuar në MB në 5 vitet e fundit është të paktën 2.5 vite.

Opsioni 2: Leje qëndrimi fleksibël (30/60)

Ju duhet të:

- Keni një "Pre-Settled Status" të vlefshëm
- Keni filluar jetesën në MB të paktën 5 vite para datës së aplikimit
- Në 60 muajt e fundit (5 vite), duhet të keni jetuar në MB për të paktën 30 muaj (2.5 vite)
- Mungesat e gjata lejohen, për sa kohë që prania juaj fizike në MB arrin të paktën 30 muaj



Kujdes me mungesat: Nëse ju jeni larguar nga MB për 2 vite rresht (pa e vizituar asnjëherë MB) para 21 Maj 2024, statusi juaj Pre-Settled ka skaduar automatikisht. Ju sugjerojmë të kërkonti ndihmë ligjore nëse ky është rasti juaj dhe vazhdoni të jetoni në MB.

Si te vertetoni qendrimin tuaj ne MB

Home Office mund t'ju kërkojë më shumë prova për qëndrimin tuaj në MB nëpërmjet emailit. Ju mund të klikoni 'Shikoni vitet për të cilat duhet të tregoni prova' në fund të aplikimit. Nëse ju nuk mund të gjeni prova shtesë të qëndrimit tuaj, kërkon ndihmë ligjore.

Të gjitha dokumentet duhet të përfshijnë emrin tuaj të plotë, adresën në MB dhe datën.

Provat e pranueshme përfshijnë:

- Deklarata bankare me transaksione në person (p.sh. fatura nga Tesco, udhëtime me TLF etj.); debitet direkte dhe pagesat online mund të mos pranohen.
- Fatura nga tatimi i qytetit, fatura shtëpiake (p.sh. të gazit, elektricitetit, ujit, taksa e televizorit etj.).
- Kontratë qeraje me dëshmi pagese.
- Listë pagesash, kontratë pune ose letër nga punëdhënësi.
- Letra nga HMRC, DWP, NHS.
- Letra nga shkolla, universiteti ose nga kurse të tjera profesionale.
- Bileta udhëtimi (p.sh. bileta avioni).
- Çdo provë tjetër që dëshmon prezencën tuaj fizike në MB.



Jo kopje



Vetëm PDF ose skanime/foto

Ju mund të ngarkoni deri në 10 dokumente (maksimumi 6 MB) për të treguar prova të qëndrimit tuaj në MB. Nëse dilni nga aplikacioni dhe futeni sërish më vonë, ju mund të ngarkoni më shumë dokumente.

Pyetjet më të shpeshta

A kam nevojë për një pasaportë biometrike ose kartë identiteti të vlefshme për të aplikuar?

Po, zakonisht kërkohet një dokument identifikimi i vlefshëm (jo i skaduar) për të aplikuar. Nëse dokumenti juaj ka skaduar, kërkoni ndihmë ligjore dhe kontaktoni Ambasadën ose Konsullatën e shtetit tuaj për ta rinovuar sa më shpejt.

Për anëtarët e familjes që nuk i përkasin BE-së:

Kartat biometrike të lejeqëndrimit mund të përdoren nëpërmjet aplikacionit kur ato kanë skaduar më pak se para 18 muajsh.

Çfarë ndodh pas aplikimit?

Pasi ju keni aplikuar për statusin 'Settled', ju nuk do të pajiseni me certifikatën e aplikimit (COA). Ju mund të vazhdoni të përdorni statusin tuaj 'Pre-Settled' për të provuar të drejtat tuaja në MB derisa të merret një vendim për aplikimin tuaj.

A ka një afat kohor?

Jo, por ju duhet të aplikoni për 'Settled' sapo të keni të drejtë për të aplikuar dhe para se të skadojë statusi 'Pre-Settled'.

Ekziston mundësia që aplikimi im të refuzohet?

Po, nëse ju nuk paraqisni prova të mjaftueshme. Gjithsesi, Home Office kërkon gjithmonë prova shtesë para se të refuzojë një aplikim. Nëse ju nuk mund të siguronit prova të qëndrimit tuaj në MB, kërkoni ndihmë ligjore. Ju keni të drejtën të apelonit vendimin e refuzuar.

Fëmija im do të përfitojë automatikisht statusin 'Settled' pas aplikimit?

Jo, çdo fëmijë duhet të aplikojë veçmas prindit. Ju mund ta lidhni aplikimin e tyre me tuajin duke përdorur numrin tuaj UAN të aplikimit për 'Settled'.

Fëmijët e lindur në MB me njërin prej prindërve mbajtës të statusit 'Settled' janë automatikisht britanikë.

Mund të aplikoj për statusin 'Settled' nëse jam ndarë nga sponsori im?

Në disa raste, ju mund të aplikoni për statusin 'Settled' nëse keni të drejtën e ruajtur të qëndrimit. Kërkoni ndihmë ligjore.

Skani kodin QR më poshtë me kamerën e telefonit tuaj për të pasur më shumë informacion.



Për më shumë informacion, ju mund të kontaktoni EU Settlement Resolution Centre (Home Office) në numrin 0300 123 7379 (ose +44 300 790 6268 nëse telefononi nga jashtë MB).

Ju mund t'i kontaktoni në web chat online:
<https://ukimmigration-support-webchat.homeoffice.gov.uk/euss>.

Ju mund të kontaktoni UK Visas and Immigration duke përdorur formularin online:
<https://www.gov.uk/contact-ukvi-inside-outside-uk>.

**Informacionet e përfshira në këtë fletëpalosje
janë të përditësuara deri më:
09.12.2025**